VENDIM
Nr. 38/2014

PËR MIRATIMIN E RAPORTIT PËRFUNDIMTAR TË KOMISIONIT HETIMOR "PËR TË KONTROLLUAR ZBATIMIN E LEGJISLACIONIT NË FUQI GJATË PROCESIT TË LËVIZJEVE TË BURIMEVE NJERËZORE TË POLICISË SË SHTETIT", NGRITUR ME VENDIMIN E KUVENDIT NR. 8/2014

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës dhe të nenit 22 të ligjit nr. 8891, datë 2.5.2002, "Për organizimin dhe funksionimin e komisioneve hetimore të Kuvendit",

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Miratimin e Raportit Përfundimtar të komisionit hetimor "Për të kontrolluar zbatimin e legjislacionit në fuqi gjatë procesit të lëvizjeve të burimeve njerëzore të Policisë së Shtetit", propozuar nga shumica e të gjithë anëtarëve të komisionit hetimor, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Miratuar në datën 5.6.2014

KRYETARI
Ilir Meta